

Aspekti Baubiologjik

Të dhënat nga matjet eksperimentale nga institute prestigjioze europjane

Radioaktiviteti

Çdo material guror ka origjinë vullkanike, dhe si të tillë në vehte përmbajnë një dozë të reaktiviteti apo rrezatimit radioaktiv. Matjet kanë tregu se ISO – Masivmuri, qëndron largë më ulët sa i përket këtij treguesi, në raport me materiale tjera:

Koncentrimi mesatar i radioaktivitetit ne Bq për kg	Radium 226	Thorium 232	Kalium 40
Tulla, Klinkeri	76	63	630
Blloku me rërë gëlqerore, Gasbetoni	19	19	220
Bllokat e betonit	81	85	890
Rëra, Zhavorri	15	15	260
Rëra-Zhavorri-Beton (Materiali mbushës i ISO-Masivmurit)	22	26	220
Polysteroli (Neopori dhe styropori)	0	0	0
Vlerat maksimale lejuara	370	260	4.810

Zjarri në ISO-MASSIVHAUS-Elementet

Materiali i përdorur është vështirë i djegshëm dhe vetshues, dmt. se nëse e djegim me flakë polisterolin, elementi shkrihet dhe digjet, por nëse i largojmë flaken ai vetshuhet.

Konkluzioni praktik:

Muret e suvatuara apo të veshura me pllaka gipsi, nuk mund të bien në kontakt direkt me flaken apo burimin e zjarrit, dhe zjarri nuk mund të buroj nga elementet ISO. Rreziku për djegjen e shtëpisë vjen nga mobileria e shtëpisë por jo nga elementet e mureve.

Edhe nëse ndodhë që në temperaturë 800 °C të shkrihen, këto elemnte nuk kanë funksion statik por vetëm termoizolues, shtëpia nuk mund të shkatërrohet komplet, pjesët e shkriera thjeshtë mund të ndërrohen dhe sërish të suvatohen.

Riciklimi

Materiali i polisterolit është material i riciklueshëm dhe ka zbatim në shumë lëmi tjera, si në punimin e materialeve termoizoluese me beton të lehtësuar, permirësimin e shkrihtësë së dheut, paktime të ndryshme të gjërave të thyeshme etj.

